



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:185229

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05508156

P.nr.37/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit H.S nga Komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Rifat Bllata, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1166/23 e datës 14.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 26.03.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri H.S dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Rifat Bllata, si dhe pala e dëmtuar J.H, më dt.26.03.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: H.S nga i ati S., e ëma S., e gjinisë S., i lindur më datë ... në Skenderaj, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pamartuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa gjykuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 28.07.2022 rreth orës 19:00 minuta, në fshatin L, Komuna Vushtrri, i pandehuri në bashkëkryerje me të miturin F.S me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit J.H, në atë mënyrë që pasi të dëmtuarin e kishte thirrur në telefon djali i tij i mitur pasi që kishte probleme me të pandehurin, i njëjti nisjet menjëherë me veturë dhe me të arritur tek shitorja në fjalë, sheh se janë duke tentuar t’ia sulmojnë djalin me thikë (mjet ky që mund të shkaktoj lëndim të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë të shëndetit) dhe t’ua afruar i pandehuri e godet me thikë në trup, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, të cilat paraqesin: plagë prerëse të regjionit të laprës së majtë,

- Me këtë në bashkëkryerje me të miturin F.S ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 dhe lidhur me nenin 31 të

KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 44, 69, 70 dhe nenit 185 par.2 lidhur me par.1, nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPK-së, e

## G J Y K O N

Të pandehurit: H.S i shqipton DËNIM MË BURG në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në periudhën prej një (1) viti.

I DËMTUARI J.H për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1166/23 e datës 21.11.2023, kundër të pandehurit H.S nga Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 nën par.1.4 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### *Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.26.03.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri H.S ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër si dhe i ka kërkuar ndjesë të dëmtuarit.

### *Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë*

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me

mbrojtësin e tij, gjykatës i propozon që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe ta merr të njëjtin si rrethanë lehtësuese, si dhe rrethanat e tjera si në aktakuzë.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av. Rifat Bllata lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë ka ardhur në mënyrë vullnetare pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e tij, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë. Njëherit i pandehuri me të dëmtuarin dhe familjen e tij janë pajtuar sipas traditave, e po ashtu i njëjti edhe në gjykatë ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur si dhe është penduar për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke i premtuar gjykatës që nuk do të përsëritet më. Gjithashtu, gjykatës i ka propozuar që të merren parasysh rrethanat që u cekën më lartë dhe me rastin e vendosjes të merr parasysh rrethanat lehtësuese pasi që vepra penale ka qenë e atëçastshme. Nëse gjykata dënim deri në 6 muaj të njëjtin ta zëvendësoj me dënim me gjobë ose dënim të kushtëzuar.

Pala e dëmtuar J.H lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurores së shtetit si dhe ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material në këtë çështje.

#### *Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë*

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Procesverbali për marrjen në pyetje të të dëmtuarit – dëshmitarit J.H në SP Vushtrri, i datës 28.07.2022, Katër fotografi të të dëmtuarit, Raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali Sheikh Zayed – Qendra Emergjente, Vushtrri, me numër të protokollit 8218, i datës 28.07.2022, Raporti Mjekësor i lëshuar nga SHKSUK – Klinika Emergjente, Prishtinë, me numër të protokollit 50131, i datës 28.07.2022, Ekspertiza mjeko ligjore e ekspertit Dr. F.D me numër të referencës 02/2023, e datës 31.08.2023, Procesverbali për intervistimin e të pandehurit H.S në SP Vushtrri, i datës 28.07.2022 si dhe Procesverbali për intervistimin e të pandehurit H.S në PTH Mitrovicë, i datës 21.09.2023.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri nga me dashje ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK -së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 185, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen *“Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në: dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër; zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim*

*deri në tre (3) vjet.”, ndërsa formë e kualifikuar e kësaj veprë është përcaktuar në par.2 të këtij neni i cili parasheh se: “Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 nën par. 1.4 dhe lidhur me nenin 31 të KPRK -së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, kërkim faljen ndaj të dëmtuarit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhor i ri përkatësisht 19 vjeçar si dhe më parë nuk ka kryer vepra penale, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, me ç’rast te i pandehuri ka ekzistuar shkalla e lartë e kryerjes së kësaj veprë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur – dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej dhjetë (10) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë penale në periudhën verifikuese në periudhën prej një (1) viti, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### *Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.*

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI**  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.37/2024, datë 26.03.2024

**GJYQTARI**  
Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.